



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 478/1 Dt. 15.03.2021

**RREGULLORE
PËR ZGJEDHJET E STUDENTËVE, THEMELIMIN DHE PUNËN E PARLAMENTIT
STUDENTOR DHE KËSHILLAT E STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN "ISA
BOLETINI", MITROVICË**

Mitrovicë
mars 2021

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Në mbështetje të nenit 151, paragrafi 3, të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit (KD) në mbledhjen e mbajtur më 15.03.2021, miratoi:

Rregullore

**për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit studentor dhe
këshillave të studentëve të Universitetit "Isa Boletini"**

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi dhe përkufizimi

1. Kjo Rregullore përcakton procedurën dhe organizimin e zgjedhjeve të studentëve si dhe konstituimin dhe punën e parlamentit studentor dhe të këshillave të studentëve të fakulteteve.
2. Shkurtesat dhe përkufizimet që përdoren në këtë rregullore e kanë kuptimin si në vijim:
 - 2.1.UIBM – Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë;
 - 2.2.KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
 - 2.3.KZF – Komisioni Zgjedhor i Fakultetit;
 - 2.4.KF – Këshilli i Fakultetit
 - 2.5.PS - Parlamenti i Studentor;
 - 2.6.KS - Këshillat e studenteve.
 - 2.7.OS – Organizatat studentore

Neni 2

E drejta për të themeluar organizata studentore

1. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët bachelor dhe master.
2. Secila organizatë studentore duhet të ketë statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj dhe në pajtim me këtë rregullore si dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës që rregullon fushën e organizatave joqeveritare.
3. Statuti i OS do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

II. Procedura dhe rregullat zgjedhore për zgjedhjet e studentëve

Neni 3

Përfaqësimi në organet qeverisëse

1. Interesat e studentëve do të përfaqësohen në Universitetin përmes këtyre organeve:
 - 1.1. Parlamenti i studentëve në nivel të Universitetit;
 - 1.2. Këshillat e studentëve në nivel të secilës njësisë akademike.
2. Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve të njësive akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.
3. Studentët të cilët kanë të përsëritur vite të studimeve nuk mund të kandidohen, përkatësisht të zgjidhen në pozita udhëheqëse studentore.
4. Studentët e studimeve themelore të cilët kanë notën mesatare më pak se tetë (8) nuk mund të kandidojnë për zgjedhje në organet përfaqësuese të studentëve.
5. Studentët e studimeve themelore dhe master të cilët propozohen nga Këshillat e Studentëve për anëtarë të Senatit duhet të kenë notën mesatare jo më pak se tetë (8) në nivelin e studimeve bachelor.
6. Nëse nota mesatare e përfaqësuesit të zgjedhur të studentëve në organet përfaqësuese të studentëve, gjatë ushtrimit të mandatit bie nën tetë (8) i njëjti nuk e humb mandatin e fituar në zgjedhje.
7. Studentët që janë pjesë e organeve drejtuese të partive politike nuk mund të kandidohen në listat zgjedhore të organizatave studentore.
8. Me rastin e diplomimit, kandidati mandatar nuk mund të vazhdojë të mbajë mandatin e fituar gjatë kohës sa ishte student. Mandati i mbetur vakant plotësohet me kandidatin e radhës së renditur në listën e certifikuar të kandidatëve.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Neni 4

Parlamenti i Studentëve

1. Parlamenti i studentëve është organ më i lartë i përfaqësimit të studentëve. Ai merr vendime për çështjet studentore në nivel të Universitetit.
2. Në bazë të nenit 44, paragrafi 1, nënpika 1.5. të Statutit, anëtarë të Senatit janë dy (2) anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve prej radhëve të studentëve të rregullt të Universitetit. Kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar ex officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Senatit. Senatorët studentë propozohen nga këshillat e studentëve të fakulteteve për tu zgjedhur nga Parlamenti studentor;
3. Parlamenti i studentëve vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe fokusohet në temat si në vijim:
 - 3.1. Interesat e studentëve në nivel të Universitetit;
 - 3.2. Angazhimi për cilësinë në mësimdhënie dhe mësimxënie;
 - 3.3. Studimet që ndërlidhen me aspektet e reformave të Universitetit dhe zhvillimet akademike;
 - 3.4. Zhvillimin e cilësisë së të mësuarit dhe të vlerësimit;
 - 3.5. Bursat universitare;
 - 3.6. Ndihmat (bursat) sociale;
 - 3.7. Çështjet tjera të përgjithshme të interesave akademike të studentëve;
 - 3.8. Organizimin e aktiviteteve kulturore e sportive.
4. Parlamenti i studentëve ka kompetencë si në vijim:
 - 4.1. Zgjedhjen e anëtarëve – studentë në Senatin e Universitetit, komisionin e studimeve të senatit dhe komisione tjera siç është e përcaktuar me Statut apo akte tjera;
 - 4.2. Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të Universitetit;
 - 4.3. Propozimet për Senatin e Universitetit, në lidhje me çështjet studentore dhe akademike;
 - 4.4. Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e Universitetit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit;



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

4.5. Çështjet tjera të ngjashme.

Neni 5

Përbërja e parlamentit të studentëve dhe mandatet

1. Parlamenti i Studentëve (PS) përbëhet prej 11 (njëmbëdhjetë) anëtarëve.
2. Anëtarët propozohen nga organizatat studentore, në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura në zgjedhjet e studentëve dhe sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga secila organizatë studentore në fillim të fushatës zgjedhore.
3. Anëtarët e Parlamentit të Studentëve zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin.
4. Ndarja e mandateve për secilën organizatë studentore që bën fushatë, varet nga numri i përgjithshëm i përqindjes së votave që arrihet gjatë zgjedhjeve sipas kësaj rregulloreje.
5. Votat e organizatave studentore, të cilat nuk e kanë arritur pragun prej 5% të numrit të përgjithshëm të votave për Parlament të Studentëve, nuk do të shpërndahen në organizatat e tjera të kualifikuara për përfaqësim në Parlament të Studentëve.
6. Zgjedhjet e Parlamentit Studentor do të udhëhiqen nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

Neni 6

Këshillat e studentëve

1. Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën njësi akademike.
2. Secili këshill i studentëve propozon listën me një kandidat për anëtarin student të Senatit për t'u zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.
3. Këshilli i studentëve i secilës njësi akademike zgjedh 2 anëtarë, përfaqësues të studentëve të Këshillit të njësisë akademike, në përputhje me nenin 69, paragrafi 3.6 të Statutit të UIBM. Kryetari i këshillit të studentëve është anëtar ex-officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të këshillit të fakultetit.
4. Secili këshill i studentëve duhet të fokusohet në temat si në vijim:
 - 4.1. Interesat e studentëve në nivel të njësisë akademike;
 - 4.2. Studimet që ndërlidhen me aspektet e reformave të fakultetit dhe zhvillimet akademik;
 - 4.3. Zhvillimi i cilësisë së mësimit dhe të vlerësimit;



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

- 4.4. Bursat universitare;
- 4.5. Ndhimat (bursat) sociale;
- 4.6. Çështjet tjera të ngjashme.
5. Secili këshill i studentëve ka kompetencë si në vijim:
 - 5.1. Propozimin e listës për një anëtar – student të Senatit;
 - 5.2. Zgjedhjen e një anëtari – student në këshillat e fakultetit;
 - 5.3. Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të fakultetit;
 - 5.4. Propozimet për këshillin e fakultetit lidhur me çështjet studentore dhe akademike;
 - 5.5. Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e fakultetit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit;
 - 5.6. Çështjet tjera të ngjashme.

Neni 7

Përbërja e këshillit të studentëve dhe mandatet

1. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të secilit këshill të studentëve është 1% i numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në atë njësi akademike, me më së paku 5 dhe më së shumti 21 anëtarë.
2. Anëtarët e këshillit të studentëve do të propozohen nga organizata studentore, në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura gjatë zgjedhjeve studentore për secilën njësi akademike dhe sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga organizatat studentore në fillim të fushatës zgjedhore.
3. Ndarja e mandateve për secilën organizatë studentore që bën fushatë, varet nga totali i përqindjes së votave të arritura gjatë zgjedhjeve sipas kësaj rregulloreje.
4. Votat e organizatave studentore të cilat nuk e kanë arritur pragun prej 3% të numrit të përgjithshëm të votave për Këshill të Studentëve nuk do të shpërndahen në organizatat e tjera të kualifikuara për përfaqësim në Këshill të Studentëve.
5. Zgjedhjet për këshilla të studentëve do të udhëhiqen nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit në bashkëpunim me Komisionin Qendror Zgjedhor.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Parimet e zgjedhjeve

Neni 8

1. Organizatat studentore që pretendojnë të marrin pjesë në zgjedhjet studentore duhet të jenë të regjistruara dhe të plotësojnë të gjitha kriteret e tjera, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
2. Regjistrimi i organizatave studentore do të bëhet në Ministrinë përkatëse të Administratës Publike, konform Ligjit në fuqi për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.
3. Të gjitha organizatat studentore, të cilat janë regjistruar në mënyrë të rregullt si “shoqatë”– “asociacion” në Ministrinë e Administratës Publike sipas ligjit në fuqi konsiderohen të regjistruara, ndërsa për themelimin e organizatave të reja ato duhet të regjistrohen së paku 15 ditë para datës së zgjedhjeve.
4. Organizatat studentore kanë të drejtë të regjistrohen për:
 - 2.1. përfaqësim të përgjithshëm të studentëve të universitetit;
 - 2.2. përfaqësim të studentëve në fakultete individuale.
5. Numri minimal i deklaratave mbështetëse nënshkruese i nevojshëm për organizatat studentore për të arritur pranueshmërinë duhet të përcaktohet sipas rregullave të kësaj rregulloreje.
6. Organizata studentore, për t’u certifikuar nga KQZ, për pjesëmarrje në zgjedhje studentore për përfaqësim në nivel të përgjithshëm të universitetit, duhet t’i siguroj 150 nënshkrime mbështetëse, ndërsa për përfaqësim të studentëve në fakultete individuale duhet t’i siguroj 50 nënshkrime.
7. Në deklaratën mbështetëse duhet të shënohet: Emri dhe mbiemri, numri i indeksit – dosjes, Fakulteti, Departamenti dhe nënshkrimi.
8. Në rast se konstatohen parregullsi ose falsifikim me rastin e plotësimit të shënimeve në listat mbështetëse, Komisioni Qendror Zgjedhor, largon nga lista mbështetëse emrin e kandidatit/es i cili gjendet edhe në lista të tjera dhe merren masa ligjore kundër tij/saj në pajtim me legjislacionin në fuqi.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

9. Data kualifikuese për organizatat studentore, për të fituar të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhjet studentore, do të caktohet 15 ditë para ditës së zgjedhjeve. Procesi i regjistrimit dhe licencimit duhet të përfundojë në atë datë.

Neni 9

Parimet e përfaqësimit dhe pragu zgjedhor

1. Anëtarët e parlamentit të studentëve dhe këshillat e studentëve do të zgjidhen në pajtim me procedurat e Statutit dhe të kësaj rregullore, ndërsa për rastet që nuk janë të rregulluara me Statut dhe këtë rregullore, përshtatshmërisht do të aplikohen dispozitat për zgjedhjet e përgjithshme në nivel të Republikës së Kosovës.
2. Përfaqësimi i studentëve në parlamentin studentor dhe këshillin e studentëve do të jetë në bazë të numrit të votave të fituara për Parlamentin e Studentëve dhe këshillat e studentëve.
3. Gjatë zgjedhjeve studentore, për Parlamentin studentor dhe këshillat e studentëve do të aplikohet sistemi i përfaqësimit proporcional. Kjo siguron që secila organizatë studentore që ka fituar numrin e përgjithshëm të votave mbi pragun përkatës të arritur, do të fitojë numrin e ulëseve në proporcion me përqindjen e votave të cilat ata i kanë marrë.
4. Pragu për nominimin e anëtarëve të organizatave studentore është:
 - 5% i numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e studentëve.
 - 3% i numrit të përgjithshëm të votave në nivel të njësisë përkatëse akademike për këshillat e fakulteteve të njësive akademike.

Neni 10

Kohëzgjatja e mandatit

1. Mandati i anëtarëve të Parlamentit të studentëve dhe i këshillit të studentëve të njësive akademike zgjat 2 vjet, pa të drejtë të rizgjedhjes.
2. Mandati i përfaqësuesit të zgjedhur në parlamentin e studentëve ose në këshill të studentëve të fakultetit përfundon para kohe në rastet si ne vijim:
 - 2.1. Me rastin e dorëheqjes;
 - 2.2. Me rastin e diplomimit të studentit të zgjedhur që ka fituar mandatin;
 - 2.3. Me rastin e humbjes së statusit të studentit që ka fituar mandatin;



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- 2.4. Në rast të shqiptimit të masës disiplinore për shkelje të rënda, me vendim të PS/KS;
- 2.5. Në rast të ngritjes së aktakuzës apo dënimit për vepër penale.
3. Procedura e përfundimit të parakohshëm të mandatit të përfaqësuesit të studentëve në parlamentin e studenteve dhe këshillat e studentëve, sipas paragrafit 2 të këtij neni, zbatohet nga Këshilli Drejtues, *ex officio*, apo sipas njoftimit të secilës organizatë studentore të përfaqësuar në parlament dhe këshilla të studentëve.

Neni 11

Shpallja e zgjedhjeve

1. Zgjedhjet e studentëve shpallen nga Këshilli Drejtues i Universitetit.
2. Zgjedhjet e studentëve mbahen jo më larg se 25 ditë pasi të shpallen zgjedhjet nga Këshilli Drejtues i Universitetit. Data e saktë përcaktohet nga Këshilli Drejtues.
3. Organizatat e studentëve që fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhjet studentore në nivel universiteti apo fakulteti duhet të mbajnë fushatën bazuar në listën prioritare të kandidatëve, gjithnjë duke respektuar Statutin dhe këtë rregullore.
4. Periudha e fushatës zgjedhore për organizatat e studentëve do të fillojë në ditë e parë pas certifikimit të organizatave studentore dhe do të përfundojë 24 orë para datës së zgjedhjeve, duke llogaritur kohën që nga ora 00:00 e ditës së shpalljes së zgjedhjeve. Zgjedhjet do të udhëhiqen nga Komisioni Qendror Zgjedhor, ndërsa do të monitorohen nga institucione, organizata dhe palë të tjera të interesit për monitorim të zgjedhjeve.
5. Shkeljet e rregullave dhe procedurave zgjedhore do të sanksionohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor dhe Këshilli Drejtues si shkallë e dytë.

Neni 12

Komisioni Qendror Zgjedhor

1. Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) themelohet nga Këshilli Drejtues në ditën e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve studentore.
2. Kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor thërret mbledhjen konstituive, më së largu brenda tri ditëve nga dita e shpalljes të zgjedhjeve, dhe udhëheq KQZ - në.
3. Komisioni Qendror Zgjedhor përbëhet nga anëtarët si në vijim:



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

- 3.1. Një profesor në marrëdhënie të rregullt pune i cili preferohet të jetë nga fusha e drejtësisë);
- 3.2. Sekretari i përgjithshëm i universitetit;
- 3.3. Një përfaqësues nga zyra ligjore e UIBM;
- 3.4. Nga një përfaqësues prej të tri organizatave më të mëdha të studentëve në kuadër të votave të fituara në zgjedhjet e fundit pa të drejtë vote.
- 3.5. Një përfaqësues i KQZ të Republikës së Kosovës, në cilësi të monitoruesit, pa të drejtë vote.
4. Kryesuesi i KQZ – së, duhet të dërgojë kërkesë me shkrim për të marrë emrat e nominuar për anëtarë të KQZ – së, nga organizatat studentore nominuese sipas paragrafit 3.4. të këtij neni që në ditën e shpalljes së zgjedhjeve. Kjo shkresë duhet t’iu dërgohet së bashku me një ftesë për mbledhjen konstituive. Nominimet duhet të dorëzohen me shkrim te kryesuesi i KQZ – së, më së voni një ditë para mbajtjes së takimit konstituiv. Nominimet e vonuara nuk do të bëjnë pezullim të procedurave.
5. Komisioni Qendror Zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore.
6. Rezultatet e zgjedhjeve shpallen ekskluzivisht nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
7. Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të aprovojë udhëzimet për votim me propozim të kryesuesit të komisionit brenda 7 ditëve pas konstituimit.

Neni 13

Komisionet Zgjedhore të fakultetit

1. Për secilin fakultet të Universitetit, KQZ duhet të themelojë komisionin e zgjedhjeve brenda pesë ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve.
2. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit përbëhet nga anëtarët si në vijim:
 - 2.1. Nga një përfaqësues prej dy organizatave më të mëdha të studentëve që kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e fundit.
 - 2.2. Sekretari i fakultetit.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- 2.3. Nominimet, nga nënpika 2.1. duhet të dorëzohen me shkrim te kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor para mbajtjes së takimit konstituiv.
3. Sekretari i fakultetit është kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit. Zëvendëskryetari zgjidhet nga mesi i anëtarëve studentë me shumicë votash.
4. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit përkrah Komisionin Qendror Zgjedhor në përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore në fakultetin përkatës.

Neni 14

Kufizimet në procesin zgjedhor

1. Asnjë student nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një zgjedhjeje apo komisioni të fakultetit.
2. Asnjë student nuk ka të drejtë që emri i tij të jetë në më shumë se një listë të kandidatëve.
3. Asnjë student i cili/cila është anëtar i një zgjedhjeje apo komisioni zgjedhor nuk ka të drejtë të mbështes listën e kandidatëve apo anasjelltas.
4. Të gjithë anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe të komisioneve zgjedhore të fakultetit duhet të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim, e cila përgatitet nga kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor, e cila thotë se ata/ato do të punojnë gjatë mandatit të tyre me përpikëri në mënyrë të paanshme dhe me ndërgjegje të plotë.
5. Këshilli Drejtues ka të drejtë që përkohësisht të suspendoj anëtarët student të zgjedhjeve apo komisionit zgjedhor të fakultetit me rekomandim të kryesuesit të Komisionit Qendror Zgjedhor, në rast të ndonjë shkelje të dëshmuar të rregullave të kësaj rregullore nga anëtarët përkatës. Në këtë rast, pozita nuk do të ri – plotësohet për periudhën gjatë suspendimit.

Neni 15

Kryesuesi i KQZ

1. Kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor është përgjegjës për:
 - 1.1. Thirrjen e takimeve të KQZ;
 - 1.2. Udhëheqjen e takimeve;
 - 1.3. Udhëzimin për procesin e vendim marrjes;
 - 1.4. Ekzekutimin vendimeve të KQZ;



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

- 1.5. Koordinimin e komisioneve të fakulteteve.
2. Kryesuesit të KQZ i caktohet një bashkëpunëtor profesional që do ta ndihmojë në përgatitjen e procesverbaleve dhe punët tjera teknike.
3. Këshilli Drejtues është i obliguar që të ofrojë mbështetje të mjaftueshme administrative për kryesuesin e KQZ, në mënyrë që t'i përmbushë obligimet e përshkruara nga kjo Rregullore.
4. Në rast se kryetari mungon, përgjegjësitë sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i marrë zëvendëskryesuesi.

Neni 16

Vëzhguesit në komision zgjedhor

Secila organizatë e studentëve që kualifikohet për pjesëmarrje në zgjedhjet e studentëve sipas kësaj rregulloreje, dhe e cila nuk është e përfaqësuar në komisionin qendror zgjedhor apo në komisionet e fakultetit, ka të drejtë të nominojë një vëzhgues në komisionin zgjedhor.

Neni 17

Zëvendësimi i anëtarëve të KQZ

Në rast të dorëheqjes të anëtarit të KQZ, kryesuesi i KQZ duhet të kërkojë nga organizata deleguese të caktojë nominimin e anëtarit brenda 24 orëve.

Neni 18

Takimet, kuorumi, vendimmarrja dhe procesverbalet e takimit në KQZ dhe KZF

1. Takimet e KQZ dhe KZF mbahen, në rast se në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve, siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Në rast se mungon kuorumi, kryesuesi mund të thërras një takim tjetër brenda 24 orësh.
3. Në rast se mungon kuorumi gjatë dy takimeve të njëpasnjëshme, kryetari e gëzon të drejtën e marrjes së vendimeve për pikat e rendit të ditës.
4. Vendimet e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe Komisionit Zgjedhor të Fakultetit merren me shumicë votash.
5. Në rast të votimit të barabartë vota e kryesuesit është vendimtare.

Neni 19



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

1. Kryesuesi obligohet që ta ftojë mbledhjen e KQZ në afatin e paraparë sipas kësaj rregulloreje, më së voni 24 orë pasi të njoftohen për rastin përkatës.
2. Thirrja (ftesa) duhet t'i dorëzohet anëtarëve më së voni një ditë para takimit. Ftesa duhet të përmbajë rendin e ditës.

Neni 20

1. Procesverbali i takimit duhet të përgatitet për çdo takim të KQZ dhe KZF. Procesverbali duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të takimit dhe të vendimeve që janë marrë. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga kryetari i KQZ-së, përkatësisht KZF-së.
2. Të gjitha procesverbalet e takimeve nga KQZ dhe të KZF duhet të ruhen nga kryetari përkatës. Nga një kopje për secilin takim duhet t'i jepet Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit dhe duhet të ruhet në arkiv për një periudhë prej tre vjetësh.

Neni 21

1. Takimi i KZF-së duhet të thirret nga kryetari i KZF-së.
2. Për udhëheqjen e takimeve të KZF-së, do të jenë të vlefshme rregullat përkatëse të kësaj rregulloreje për KQZ-në.

Neni 22

Përgjegjësitë e KQZ – së

1. Komisioni Qendror Zgjedhor ka këto përgjegjësi:
 - 1.1. Përcaktimin dhe zbatimin e dinamikës së zgjedhjeve; të përcaktuar nga Këshilli Drejtues;
 - 1.2. përgatitjen e listave për zgjedhje të personave me të drejtë zgjedhjeje;
 - 1.3. vendimet rreth kundërshtimeve kundër listës së zgjedhjeve;
 - 1.4. konstatimi i numrit të përgjithshëm të mandateve;
 - 1.5. vlerësimi i listës së kandidatëve;
 - 1.6. kryesimi i procedurave zgjedhore;
 - 1.7. verifikimi përfundimtar i identitetit i të votuesve;
 - 1.8. konstatimi i rezultateve të zgjedhjeve;
 - 1.9. dhënia e mandatit për t'i pranuar organizatat dhe kandidatët e zgjedhur.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- 1.10. informimi i kandidatëve;
 - 1.11. shpallja e rezultateve të zgjedhjeve;
 - 1.12. zëvendësimi i mandatit;
 - 1.13. konstituimi i parlamentit të studentëve;
 - 1.14. koordinimi i komisioneve zgjedhore të fakulteteve për konstituimin e këshillave të studentëve;
2. Lista e organizatave të pranuar të studentëve duhet të shpallen publikisht më së voni 14 ditë para ditës së zgjedhjeve.
 3. Listat e kandidatëve duhet të shpallen publikisht më së voni 5 ditë para ditës së zgjedhjeve.
 4. Rezultatet e zgjedhjeve duhet të shpallen publikisht brenda 5 ditëve pas ditës së zgjedhjeve. Mandatet duhet të caktohen në kohë të njëjtë.

Neni 23

Listat e studentëve me të drejtë vote

1. ~~Administrata Qendrore dhe shërbimi i studentëve të njësive akademike janë të obliguar t’ia~~ sigurojnë listën përfundimtare KQZ-së, me të gjitha të dhënat e studentëve që kanë të drejtë të votojnë, më së voni 7 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve të studentëve nga Këshilli Drejtues.
2. Studentët me të drejtë votë duhet t’i përmbushin këto dy kualifikime si në vijim:
 - Të kenë statusin e studentit të rregullt, të përcaktuar me nenin 139, nënpika 2.1. të Statutit të Universitetit.
 - Të kenë ID kartën, që dëshmon se studenti është i regjistruar në vitin akademik në të cilin mbahen zgjedhjet.
3. Lista e studentëve që kanë të drejtë të votojnë duhet të bëhet publike dhe të jetë e qasshme për KQZ-në brenda 7 ditëve pasi që zgjedhjet të jenë shpallur nga Këshilli Drejtues.
4. Listat finale të studentëve me të drejtë vote do të publikohen jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve.
5. Brenda periudhës nga publikimi i listave, sipas paragrafit 4 të këtij neni, secili studentë ka të drejtë të ankohet kundër përmbajtjes së listës përmes deklaratës me shkrim e cila mund t’i parashtrohet KQZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

6. Ankesat kundër listës së studentëve me të drejtë vote duhet të paraqitën më së voni brenda tri ditëve pas shpallje së listave, dhe KQZ duhet të vendosë për ato kundërshtime brenda 24 orëve pas pranimit të tyre. Vendimi i KQZ, në lidhje me ankesat është përfundimtar në procedurë administrative.

Neni 24

Lista e kandidatëve

1. Organizatat e studentëve me të drejtë pjesëmarrje në zgjedhje për parlament studentor apo këshilla të studentëve, sipas parimeve të kësaj rregulloreje, duhet të dorëzojnë listat e kandidatëve në KQZ më së voni 5 ditë pas certifikimit, duke përdorur formularin e Listës së Kandidatëve ashtu siç është paraqitur në bashkëngjitjen 2. Pasi të dorëzohet lista te KQZ, ajo nuk do të ndryshohet më.
2. Secila listë e kandidatëve duhet të përmbajë:
 - 2.1. Emrin e organizatës studentore, e certifikuar në zgjedhje;
 - 2.2. Organin qeverisës që do të zgjidhet, (parlamentin studentor apo këshillin e studentëve;
 - 2.3. Listën prioritare të kandidatëve;
 - 2.4. Deklaratën e pëlqimit të kandidatëve;
 - 2.5. Personin e autorizuar të organizatës studentore, i cili duhet të ketë statusin e studentit.
3. Në rast se në listat e kandidatëve për parlament të studentëve dhe këshilla të studentëve kandidaturat janë të njëjta, në dy apo më shumë organizata studentore, KQZ – ja duhet të kërkojë nga kandidatët që të deklarohen se cilën organizatë do ta përfaqësojnë në zgjedhje, së paku 14 ditë para ditës së zgjedhjeve. Në rast se kandidatët nuk deklarohen brenda këtij afati, rreth përfaqësimit të organizatës përkatëse, KQZ –ja vendos që të njëjtit t'i heq nga lista e kandidimit të të gjitha organizatave ku ata përfaqësohen.
4. Në rast të emrave kontradiktor të dy apo më shumë organizatave të ndryshme studentore, KQZ duhet të kërkojë nga personat e autorizuar të secilës organizatë të përfshirë që të gjejnë një zgjedhje së paku 7 ditë para ditës së zgjedhjeve. Në rast se nuk gjendet ndonjë marrëveshje deri në atë datë, KQZ vendos për përjashtimin nga zgjedhjet.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

5. Organizatat studentore të UMIB – it, të cilat kanë qenë të përfaqësuara edhe më parë në përfaqësimin e studentëve, do të kenë të drejtën t'i mbajnë emrat e tyre.
6. Përdorimi i emrave të partive politike ekzistuese të Kosovës, si emra të organizatave të studentëve nuk do të lejohet.

Neni 25

Përmbajtja e listës së kandidatëve

1. Lista e kandidatëve e organizatave studentore duhet të përbëhet prej maksimumit, sa dyfishi i mandateve të lejueshme që të zgjidhet një organ përfaqësues, parlament ose këshilla të studentëve. Nëse lista e organizatës studentore nuk përpilohet sipas përmbajtjes së përcaktuar në këtë paragraf, përgjegjësinë për efektet e mëtutjeshme në procesin zgjedhor e merr organizata studentore përkatëse.
2. Asnjë student që nuk figuron në listën e kandidatëve të publikuar nga KQZ, nuk mund të ushtrojë mandat në Këshill të studentëve apo në Parlament të Studentëve.
3. Për secilin kandidat, që duhet të përmbushë kualifikimin sipas nenit 23 (2), në mënyrë që kandidatura të jetë e ligjshme duhet të ofrohen informacionet (të dhënat) si në vijim.
 - Emri dhe Mbiemri;
 - Vendi i lindjes;
 - Data, muaji dhe viti i lindjes;
 - Adresa;
 - Fakulteti;
 - Numri i ID kartelës;
 - Dëshmia e regjistrimit të studentit të rregullt – vula;
 - Deklarata e pëlqimit.
4. Kandidatët të cilët nuk i përmbushin këto kualifikime për të pasur të drejtë vote sipas nenit 23 paragrafi (2), KQZ i largon nga lista e kandidatëve.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË**

Neni 26

Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve

1. Në listën e kandidatëve, çdo i treti kandidat duhet të jetë femër.
2. Për detaje tjera të përfaqësimit gjinor të listës së kandidatëve, KQZ – ja i referohet Ligjit për Barazi Gjinore dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm në republikën e Kosovës.

Neni 27

Vlefshmëria e listës së kandidatëve

1. Vlefshmëria e listës së kandidatëve duhet të kontrollohet nga KQZ menjëherë pasi të merret nga Organizata Studentore.
2. Në rast të parregullsive të evidentuara nga KQZ – ja, lista e kandidatëve i kthehet përfaqësuesit të autorizuar të organizatës studentore përkatëse, me shpjegimet e nevojshme për përmirësim.
3. Lista e përmirësuar e kandidatëve duhet të dorëzohet te KQZ nga organizata studentore më së voni 7 ditë para zgjedhjeve.
4. Nëse lista zgjedhore apo lista e kandidatëve, e cila është kthyer për përmirësim, nuk dorëzohet brenda periudhës kohore të caktuar, kandidatura e organizatës përkatëse studentore konsiderohet si e tërhequr.

Neni 28

Tërheqja e kandidatëve nga lista

1. Secila organizatë studentore do të ketë të drejtën të tërheqë kandidaturën e saj përmes deklaratës me shkrim, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar, më së voni 7 ditë para zgjedhjeve.
2. Kandidatura e organizatës studentore do të konsiderohet si e tërhequr, nëse numri i kërkuar i kandidatëve sipas kësaj rregulloreje nuk është dhënë për arsye se kandidatët kanë tërhequr kandidaturën me shkrim dhe deklaratën e nënshkruar, më së voni 7 ditë para zgjedhjeve.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Neni 29

Afati i dorëzimit të listës së kandidatëve

1. Lista zgjedhore apo lista e kandidatëve, e cila nuk dorëzohet brenda periudhës së caktuar me këtë rregullore, nuk pranohet nga KQZ.
2. Lista e kandidatëve duhet të dorëzohet personalisht nga personi i autorizuar i organizatës studentore në kopje fizike dhe elektronike.
3. KQZ duhet të aranzhojë në periudhën para zgjedhjeve një fushatë informuese përmes fletushkave për studentët me të drejtë vote, duke i informuar për procedurat zgjedhore. Këshilli Drejtues është i obliguar të ofrojë resurset e nevojshme për një proces të tillë zgjedhor dhe të njëjtat t'i bëjë publike.

Neni 30

Mbajtja e zgjedhjeve

1. Zgjedhjet mbahen në ditën e caktuar nga Këshilli Drejtues.
2. Qendrat e vendotimeve në të gjitha njësitë akademike hapen në ora 8:00 dhe mbyllen në ora 17:00, përjashtimisht nga kjo nëse në kohën e mbylljes së vendotimeve ka radhë të votuesve atëherë koha e mbylljes së vendotimit shtyhet deri në votimin e studentit të fundit.
3. Numrin e vendotimeve nëpër fakultete e cakton KQZ.

Neni 31

Qasja në vendvotim

1. KZF është i obliguar që të ofrojë vendvotime të përshtatshme zgjedhore për mbajtjen e zgjedhjeve. Pajisjet e nevojshme, siç janë: kutitë e votimit, kabinat e votimit dhe pajisje tjera të nevojshme për votim duhet të sigurohen nga KQZ.
2. Gjatë procesit të zgjedhjeve, përveç anëtarëve të KQZ-së dhe KZF-së, në vendvotime mund të kenë qasje personat si në vijim:
 - vëzhguesit zyrtar të caktuar për zgjedhje;
 - votuesit;
 - personeli tjetër i caktuar zyrtar, përgjegjës për funksionim të rregullt.
3. Pasi vota të jetë hedhur, votuesit duhet të largohen nga vendvotimi pa vonesë.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

4. Nëse paraqitet si e nevojshme, për arsye të funksionimit të rregullt të procedurës zgjedhore, kryesuesi i KQZ-së ose KZF-së ka të drejtë të kufizojë qasjen e votuesve në vetëm nga një votues sipas radhës.
5. Në hyrje të vendotimeve nuk lejohet prezenca e përfaqësuesve të organizatave studentore, të cilët nuk janë cekë në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 32

1. Secili vendotim duhet të ketë së paku një kabinë votimi.
2. Kabina e votimit duhet të vendoset në atë pozicion, në mënyrë që votuesi të mos jetë i vëzhguar nga persona të tjerë që janë të pranishëm në vendotim gjatë procedurës së votimit.
3. Gjate kryerjes së procesit të votimit ndalohet përdorimi i telefonit dhe fotografimi i votës. Nuk lejohet asnjë veprim tjetër që cenon fshehtësinë e votës. Në rast të çfarëdo keqpërdorimi të drejtave të votimit zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 33

Fletëvotimet dhe materiali zgjedhor

1. Fletëvotimet dhe materiali zgjedhor përgatitet nga KQZ dhe shpërndahet në fakultete, nëpërmes KZF – ve.
2. Fletëvotimet për Këshilla të Studentëve dhe për Parlament të Studentëve duhet të dallohen përmes ngjyrës.
3. Fletëvotimet duhet të palosën së paku njëherë para se të hidhen në kutinë e votimit.

Neni 34

Respektimi i procedurave zgjedhore

1. KQZ, respektivisht KZF është përgjegjës për respektimin e procedurave zgjedhore në pajtueshmëri me rregulloren për zgjedhje.
2. Çdo parregullsi në lidhje me procedurat zgjedhore, raportohet sipas kësaj rregullore.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Neni 35

Mënyra e votimit

1. Votimi duhet të bëhet personalisht. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të votojnë pa ndihmën e personit përcjellës, kanë të drejtë të zgjedhin një person i cili do t'i ndihmojë gjatë procedurës së votimit.
2. Përveç përjashtimit nga paragrafi 1 të këtij neni, në kabinën e votimit mund të hyjë vetëm nga një person sipas radhës.

Neni 36

Verifikimi i votuesve

1. Secili votues është i obliguar ta dëshmojë identitetin e tij/sajë para KZF-së përmes paraqitjes së ID kartelës së studentit.
2. Vlerësimi i pranueshmërisë duhet të bëhet ekskluzivisht në bazë të listës zgjedhore për personat që kanë të drejtë votimi.

Neni 37

E drejta e votës dhe gabimi gjatë votimit

1. Secili student me të drejtë vote ka të drejt të votojë për:
 - 1.1. Parlamentin Studentor të Universitetit;
 - 1.2. Këshillin e studentëve në fakultetin ku ai/ajo është listuar si student me të drejtë vote.
2. KZF e drejton votuesin për të hyrë në kabinën e votimit.
3. Votuesi e mbush fletëvotimin, e palos njëherë dhe del jashtë kabinës së votimit.
4. KZF tërheq mbulesën e kutisë së votimit dhe votuesi e fut fletëvotimin e palosur në kuti të votimit.
5. Në rast se ndodh ndonjë gabim nga votuesi gjatë mbushjes në fletëvotim, KZF është i obliguar t'i ofrojë edhe një fletëvotim me kërkesën e votuesit. Fletëvotimi paraprak duhet të anulohet nga KZF në prani të votuesit.
6. Dorëzimi i fletëvotimit shtesë duhet të regjistrohet në protokollet e votimit.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË**

Neni 38

Regjistrimi i votuesve

- (1) Studenti i cili ka hedhur votën, duhet të regjistrohet në regjistrin e votimit nga një anëtar i KZF-së. Për regjistrim përdoret *Formulari nr.4* i kësaj rregulloreje.
- (2) Emri duhet të regjistrohet me numrin original të listës së votuesve me të drejtë vote.
- (3) Anëtari tjetër i KZF-së duhet të evidentojë emrin e votuesit në listën e votuesve me të drejtë vote.

Neni 39

Mënyra e regjistrimit të votuesve

Votimi duhet të regjistrohet në ID kartelë, përmes markerit special në pjesën e prapme të kartelës.

Neni 40

Qartësimi i identitetit të votuesit

1. Në rast të dyshimit të identitetit të studentit, KZF ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë të identifikimit.
2. Nëse identiteti nuk mund të qartësohet, studentin nuk lejohet të votojë.
3. Pasi të dorëzohet fletëvotimi, asnjë dyshim tjetër sa i përket identitetit të votuesit nuk merret parasysh.

Neni 41

Përmbajtja dhe formati i fletëvotimit

1. Për fletëvotim përdoret formulari i Fletëvotimit sipas të formularit *nr.5* të kësaj rregulloreje.
2. Renditja e organizatave studentore në fletëvotim duhet të përcaktohet përmes hedhjes së shortit e cila realizohet nga KQZ – ja.
3. Përgatitja e fletëvotimeve duhet të realizohet nga KQZ-ja, sipas dinamikës së përcaktuar.

Neni 42

Vlefshmëria e fletëvotimit

Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm, nëse aty ka evidencë të padiskutueshme për organizatën studentore apo kandidatin të cilin votuesi e ka zgjedhur. Ky është rasti kur votuesi shënon



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

qarkun në të majtë të emrit të organizatës së pranueshme apo kandidatit me një iks (x) apo me tik (√), në mënyrë që qëllimi i votuesit për të zgjedhur organizatën apo kandidatin përkatës tregohet me qartësi.

Neni 43

Fletëvotimi i pavlefshëm

1. Fletëvotimi njihet si i pavlefshëm, nëse:
 - 1.1. Fletëvotimit griset në një pjesë në atë mënyrë që nuk do të ketë mundësi të qartësohet se cila organizatë studentore apo kandidat është zgjedhur;
 - 1.2. Kur asnjë organizatë studentore apo kandidat nuk është shënuar;
 - 1.3. Kur dy apo më shumë organizata studentore apo kandidatë janë shënuar.
 - 1.4. Kur shënimi apo shenjat në fletëvotime janë bërë në atë mënyrë që nuk mund të përcaktohet se cila organizatë apo kandidat është votuar.
 2. Fjalët, komentet apo shenjat tjera të cilat shënohen në fletëvotim e bëjnë fletëvotimin e pavlefshëm.
-

Neni 44

Numërimi i votave dhe dorëzimi i rezultateve

1. Pasi të përfundojë periudha zgjedhore, kryesuesi i KZF-së deklaron përfundimin e votimeve. Vendvotimi duhet të mbyllet vetëm nga anëtarët e KZF-së, në praninë e vëzhguesve dhe monitoruesve të certifikuar.
2. KZF, i zbrazë kutitë me fletëvotime dhe:
 - 1.1. Numëron fletëvotimet për secilin organ të votuar;
 - 1.2. Konstaton numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në regjistrat e votimeve;
 - 1.3. Në rast të mos përputhjes së rezultateve sipas pikës 1 dhe 2 të këtij paragrafi, identifikon arsyet e kësaj mospërputhjeje.
2. KZF shpalos fletëvotimet, i rregullon ato sipas organit të votuar, kontrollon vlefshmërinë, identifikon fletëvotimet e pavlefshme sipas numrit të radhës dhe konstaton:
 - 2.1. Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura në kuti të votimit;
 - 2.2. Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura të pavlefshme;



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- 2.3. Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura të vlefshme;
- 2.4. Numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme për secilën organizatë studentore.
3. Rezultatet sipas paragrafit 3 të këtij neni, menjëherë pas numërimit të votave i dorëzohen kryesuesit të KQZ-së, në kopje të fortë dhe elektronike.

Neni 45

Raporti i KZF për rezultatet e zgjedhjeve

1. KZF, brenda 24 orëve pas mbylljes së vendvotimit, duhet të dorëzojë në KQZ një raport me shkrim për procedurën zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve. Për protokoll duhet të përdoret formulari i Protokollit të Procedurës së Zgjedhjeve sipas të formularit nr.6 të kësaj rregulloreje.
2. Raporti duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:
 - 2.1. Emrin e vendvotimit dhe datën e votimit;
 - 2.2. Emrat e anëtarëve të KZF-së;
 - 2.3. Emrat e vëzhguesve dhe monitoruesve;
 - 2.4. Numrin e saktë të fletëvotimeve të dorëzuara për secilin organ që është në zgjedhje;
 - 2.5. Kohën e fillimit dhe e mbarimit e periudhës së zgjedhjeve;
 - 2.6. Vendimet e KZF-së për moslejimin eventual të ndonjë votuesi për votim;
 - 2.7. Vendime tjera të KZF-së gjatë periudhës së zgjedhjeve (p.sh. pengimet gjatë periudhës së zgjedhjeve, votimet përmes përcjelljes mbështetëse të ndonjë studenti me aftësi të kufizuara etj.)
3. Këtij raportit duhet t'i bashkëngjiten edhe:
 - 3.1. Lista e votuesve me të drejtë vote;
 - 3.2. Regjistri i votimit;
 - 3.3. Votat e pavlefshme, të ndara, paketuara dhe të markuar për secilin organ që është në zgjedhje;
 - 3.4. Votat e vlefshme, të ndara, paketuara dhe të markuar për secilin organ kandidat që është në zgjedhje;



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

- 3.5. Fletë votimet e pa shfrytëzuara.
4. Raporti duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të KZF-së, vëzhguesit dhe monitoruesit. Në rast të refuzimit të nënshkrimit, arsyet duhet të evidentohen në raport.

Neni 46

Pengimi i procesit të votimit

1. Në rast të rrethanave të veçanta apo incidenteve në vendvotim, KZF ka të drejtë të ndërpres procesin e votimit dhe vazhdojë votimin në një ditë tjetër.
2. Në rastet kur personat e paautorizuar pa përjashtim, në formate ndryshme ndërhyjnë në proces të zgjedhjeve, KZF respektivisht KQZ, do të ndërmarrin veprimet e duhura ligjore për raportim të rastit në organet vendimmarrëse të Universiteti, e që nuk përjashtohet edhe iniciimi i procedurës penale pranë organeve kompetente shtetërore.
3. Secila shtyrje e zgjedhjeve duhet të shpallet në publik pa vonesë nga kryesuesi i KZF-së.
4. Nëse procesi i votimit ka filluar dhe pastaj pengohet, të gjitha veprimet zgjedhore, fletëvotimet dhe kutitë e votimit duhet të mbyllet nga kryesuesi i KZF-së derisa procedura zgjedhore të vazhdohet.
5. Përkitazi me zbatimin e këtij neni kryesuesi i KZF – së informon policinë e dhe KQZ – në.

Neni 47

Shpërndarja e mandateve të fituara

1. Shpërndarja e mandateve duhet të kalkulohet nga KQZ në pajtim me këtë rregullore.
2. Për shpërndarjen e mandateve duhet të përdoret formulari për Dhënin e Mandateve sipas të formularit *nr. 7* të kësaj rregullore.

Neni 48

Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve

1. Rezultati preliminar i zgjedhjeve duhet të publikohet nga KQZ, më së largu 24 orë pas përfundimit të zgjedhjeve.
2. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve duhet të publikohet nga KQZ, më së largu 5 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve.
3. Shpallja duhet të përmbajë:



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- 3.1. Rezultatin e zgjedhjeve në numra, të renditur sipas organizatës studentore;
- 3.2. Numrin e përgjithshëm të mandateve për secilën organizatë studentore të votuar për parlament studentor dhe këshilla të studentëve;
- 3.3. Listën e kandidatëve për secilin organ.

Neni 49

Konfirmimi i mandateve

1. Studentët që kanë fituar mandate duhet të informohen nga KQZ, përmes personit të autorizuar të organizatës studentore, në ditën e shpalljes së rezultateve përfundimtare.
2. Për letrën informuese mund të përdoret formulari për Njoftimin e Mandatarëve sipas të formularit *nr. 8* të kësaj rregulloreje.
3. Mandati konsiderohet i pranuar, nëse mandatarin nuk e kundërshton zgjedhjen e tij brenda dy ditëve pasi që rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të jetë shpallur.
4. Në rast të kundërshtimit apo dorëheqjes nga mandatarin, mandati duhet t'i caktohet kandidatit vijues sipas listës së kandidatëve.

Neni 50

Ankimimi ndaj procesit zgjedhor

1. Kundërshtimet ndaj shkeljes së procedurave dhe rezultateve të zgjedhjeve të studentëve duhet t'i dorëzohen KQZ-së brenda 24 orëve pasi të jenë shpallur rezultatet preliminare të zgjedhjeve.
2. Kundërshtimet eventuale të studentëve dhe organizatave studentore ndaj rezultateve zgjedhore, shqyrtohen dhe vendosen nga KQZ brenda 24 orëve pas pranimit të tyre.
3. Ankesat ndaj vendimeve të KQZ – së, lidhur me kundërshtimet sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, shqyrtohen dhe vendosen nga Këshilli Drejtues si shkallë e dytë.
4. Çdo ndryshim në rezultatin e zgjedhjeve për arsye të pranimit të ankesave duhet të shpallet publikisht nga KQZ.
5. Vendimi i Këshillit Drejtues është përfundimtar.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Neni 51

Përsëritja e procesit zgjedhor

1. Nëse Këshilli Drejtues konstaton se shkeljet e procedurave zgjedhore kanë qenë të atyre përmasave që esencialisht kanë ndikuar në rezultatin zgjedhor, atëherë procesi zgjedhor do të përsëritet sipas procedurës së njëjtë vetëm në fakultetin përkatës, brenda 7 ditëve pas marrjes së vendimit nga Këshilli Drejtues.

III. Konstituimi dhe puna e Parlamentit studentor dhe këshillave të studentëve

Neni 52

Parimet e konstituimit të Parlamentit studentor dhe Këshillave të studentëve

1. Parlamenti studentor dhe këshillat e studentëve duhet të konstituohen në afat prej 7 ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore. Parlamenti studentor dhe këshillat e studentëve konsiderohen se janë konstituuar me zgjedhjen e kryetarit të parlamentit, respektivisht të këshillit të studentëve.
2. Shpërndarja e mandateve duhet të kalkulohet nga KQZ në pajtim me këtë rregullore.
3. Të drejtën për të zgjedhur kryetarin e parlamentit apo të këshillit të studentëve e kanë secila organizatë studentore që ka fituar vende në parlamentin studentor apo në këshillin e studentëve dhe të cilët kanë shumicën e nevojshme për zgjedhjen e kryetarit të parlamentit dhe këshillit të studentëve.
4. Lidhur me propozimin e kryetarit të PS/KS, organizatat studentore mund të deponojnë, paraprakisht, marrëveshjen e nënshkruar për koalicion me të cilën dëshmojnë që kanë krijuar shumicën e nevojshme për të zgjedhur kryetarin e parlamentit të studentëve apo këshillit të studentëve. Marrëveshja e nënshkruar nga organizatat studentore deponohet në KQZ respektivisht KZF dhe në marrëveshje duhet të jenë të nënshkruar anëtarët e parlamentit studentor që kanë fituar mandate dhe që janë pjesë e marrëveshjes për të votuar kryetarin e parlamentit të studentëve. Në çdo rast marrëveshja duhet të deponohet në KQZ apo KZF, brenda afatit prej 5 ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve përfundimtare.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

5. Mbledhjen konstituive të parlamentit të studentëve e udhëheq KQZ, kurse mbledhjen konstituive të këshillit të studentëve e udhëheq KZF. Mbledhja konstituive, me qëllim të zgjedhjes së kryetarit të parlamentit të studentëve thirret nga KQZ, në afat prej 7 ditësh pas certifikimit të zgjedhjeve studentore.
6. Nëse është arritur marrëveshja nga organizatat studentore, për parlament studentor dhe këshilla të studentëve, sipas paragrafit 4 të këtij neni, ajo ka karakter obligues për të gjitha organizatat studentore që e kanë nënshkruar dhe e njëjta nuk mund të ndryshohet, përderisa nuk ka një marrëveshje tjetër në mes të organizatave studentore, respektivisht një shumicë të re përmes një marrëveshje të re, për parlament apo këshillë të studentëve.
7. Në rastin kur është deponuar një marrëveshje, të drejtën e propozimit të kryetarit të parlamentit të studentëve apo të këshillit të studentëve në mbledhje konstituive e kanë organizatat që kanë deponuar marrëveshjen, sipas paragrafit 4, ashtu siç përcaktohet në marrëveshje.
8. Mbledhjet konstituive thirren pas përfundimit të periudhës së caktuar për njoftimin e mandateve dhe refuzimin e mandateve duke u bazuar në nenin 49 të kësaj rregullore. Ftesa duhet të bëhet për secilin mandatar në mënyrë individuale nga kryesuesi i komisionit zgjedhor duke shfrytëzuar formularin numër 8 të rregullores për zgjedhjet studentore të Universitetit.
9. Refuzimi (mospranimi) i mandateve duhet të bëhet ashtu siç parashihet në nenin 49, paragrafi 4 i kësaj rregullore. Mandatari zëvendësues duhet të zgjidhet nga lista zyrtare e kandidatëve dhe zëvendësimi duhet zyrtarisht ti paraqitet KQZ – së apo KZF – së, nga kryetari i organizatës përkatëse studentore brenda afatit prej 3 ditëve të punës.
10. Procedura e zëvendësimit për mandatarë nuk duhet të ketë ndonjë efekt të shtyrjes dhe duhet të i përmbahet procedurave dhe orareve për konstituim dhe funksionim të mëtutjeshëm të organeve studentore.
11. Në rast të refuzimit të njëpasnjeshëm të mandateve nga personat pasues në listë të kandidatëve, dhe nëse lista nuk posedon kandidatë tjerë, atëherë KQZ duhet të kërkojë nga kryesuesi i organizatës përkatëse studentore nominimin e kandidatit të ri brenda periudhës prej 3 ditëve të punës. Ky kandidat duhet të plotësojë parakushtet ashtu si parashihen në këtë Rregullore, në të kundërtën KQZ, brenda afatit prej shtatë ditëve, jep arsyetimin me shkrim për shkaqet e refuzimit.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

12. Gjatë procedurës së rinominimit të mandatit, i cili mandat paraprakisht është refuzuar nga i nominuari fillestar, ky mandat formalisht nuk duhet të pengojë funksionimin e punës në organin përkatës. Mandati as nuk mund të delegohet dhe as nuk mund të llogaritet për kuorum.
13. Mandati i dhënë anëtarëve të PS/KS mund të tërhiqet në çdo kohë nga Parlamenti i studentëve me vota të shumicës absolute të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të PS, kur konsiderohet se është cenuar kodi etik, përkatësisht dispozitat përkatëse të kësaj Rregulloreje.
14. Ankesat përkatëse mund të dorëzohen pranë Këshillit Drejtues nga secili anëtar i organit përkatës. Procedura e rinominimit duhet të bëhet ashtu si parashihet në këtë nen.
15. Parlamenti i studentëve përmes konsultave, në këto detyra funksionale, ndihmohet nga Këshilli Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit.

Neni 53

Mandati dhe verifikimi

1. Mandati i anëtarëve të PS/KS fillon me 1 tetor të vitit kur janë mbajtur zgjedhjet studentore.
2. Mandati i anëtarëve të PS/KS zgjatë dy (2) vjet, pa të drejtë të rizgjedhjes (neni 151, paragrafi 5 i Statutit të UIBM).
3. Në mbledhjen konstituive të PS dhe KS, mandati i secilit anëtarë duhet të verifikohet nga KQZ, përkatësisht KZF, duke u bazuar në listën zyrtare të mandatarëve e cila është përgatitur nga Komisioni qendror për zgjedhje studentore.
4. Verifikimi i mandateve duhet të regjistrohet në proces verbal të mbledhjes. Mandatarët të cilët nuk mund të verifikohen duke u bazuar në dokumentacionin përkatës të komisionit për zgjedhje studentore, të njëjtët duhet të largohen nga mbledhja. KQZ kërkon nga organizata përkatëse studentore të bëjë rinominimin e mandatarëve ashtu si parashihet në këtë Rregullore.

Neni 54

Deklarata etike

Me fillimin e mandatit të tyre, secili anëtarë i PS dhe KS duhet të nënshkruaj deklaratën etike si më poshtë: **“Deklaroj se do ti kryej detyrat e mia me nder dhe besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me integritet dhe përgjegjësi dhe do të kontribuoj në përmbushjen e detyrave të PS**



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË**

dhe KS, do të ushtroj mandatin tim me vigjilencë dhe përkushtim në interes të Universitetit dhe gjatë punës time do ti përmbahem Statutit të Universitetit “Isa Boletini”.

Neni 55

Zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit dhe sekretarit të parlamentit studentor

1. Kryetari i PS duhet të zgjidhet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të PS. Kryetari i PS zgjidhet gjatë mbledhjes të kryesuar nga kryetari i KQZ – së.
2. Nëse asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk e fiton shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e parë të votimit, atëherë organizohet radha e dytë e votimit për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk e merr shumicën e votave absolute edhe në radhën e dytë të votimit, atëherë kandidati konsiderohet i refuzuar dhe procedura zgjedhore rifillohet sipas paragrafit 1 të këtij neni, në këtë rast kandidati i refuzuar paraprakisht, largohet nga kandidatura.
3. Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet dy herë. Nëse prapë ka vota të barabarta pas këtyre dy radhëve të votimeve, procedura zgjedhore duhet të rifillojë sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Në rast se asnjë kandidat nuk arrin shumicën absolute të votave pas tri radhëve të votimit të njëpasnjëshëm ashtu si parashihet në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, atëherë radha e katër dhe vendimtare e votimit duhet të mbahet me tre kandidatët paraprak të refuzuar si kandidatët e vetëm. Kandidati i cili fiton shumicën e thjeshtë të votave duhet të zgjidhet si kryetar i ri. Në rast të votave të barabarta, kandidatët me më së shumti vota të fituara garojnë në radhën e dytë të votimit.
5. Në rast se votat mbeten të barabarta edhe pas tri radhëve të njëpasnjëshme të votimeve sipas paragrafit 4 të këtij neni, mbledhja konstituive ndërpritet dhe thirret përsëri nga kryesuesi i KQZ brenda 48 orëve.
6. Pas mbledhjes konstituive të përsëritur, të gjithë kandidatët e refuzuar gjatë proceduarave paraprake të votimit duhet të përjashtohen nga kandidatura për pozitën e Kryetarit. Procedura zgjedhore pastaj duhet të rifillojë duke u bazuar në dispozitat e këtij neni.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

7. Pas zgjedhjes së Kryetarit, zgjidhet sekretari me shumicën e thjeshte të votave përmes votimit të hapur.
8. Pas kryerjes së zgjedhjes së Kryetarit dhe sekretarit, Kryesuesi i KQZ ia dorëzon udhëheqjen e mbledhjes Kryetarit ndërsa procesverbali i dorëzohet sekretarit të zgjedhur.

Neni 56

1. Kryetari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute të votave (50+1), përmes një votimi në bazë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të PS.
2. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të kryetarit, nënkryetari i parë e merr kryesimin e përkohshëm dhe brenda shtatë ditëve e thërret takimin për rizgjedhje të kryetarit.
3. Sekretari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute të votave (50+1), përmes një votimi duke llogaritur numrin e anëtarëve të pranishëm të PS.
4. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të sekretarit, kryetari cakton njërin nga dy nënkryetarët pa ndonjë vonesë, përkohësisht në marrjen e obligimeve të sekretarit dhe duhet të caktojë një pikë në rendin e ditës të po atij takimi për zgjedhjen e sekretarit të ri.

Neni 57

Zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit dhe sekretarit të Këshillit të studentëve

1. Kryesuesi i KS duhet të zgjedhat me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KS. Kryetari i KS zgjidhet gjatë mbledhjes të kryesuar nga kryetari i KZF – së.
2. Të gjitha procedurat e votimit për zgjedhje dhe shkarkimin e kryetarit dhe sekretarit të KS duhet të zhvillohen në pajtim të nenit 55 të kësaj Rregulloreje.

Neni 58

Zgjedhja dhe shkarkimi i nënkryetarit të PS dhe nënkryetarit të KS

1. PS mund të zgjedh deri në dy nënkryetar, secili KS mund të zgjedh deri në dy nënkryetar. Vendimi për këtë numër mund të merret me votim të hapur me shumicën e thjeshtë të votave.
2. Kryetari dhe nënkryetari duhet të jetë nga organizata të ndryshme studentore.
3. Secili nënkryetar duhet të zgjidhet në votime të ndara me shumicën e thjeshtë të votave. Propozimet për kandidatë bëhen njëkohësisht gjatë takimit dhe pastaj votohen në pajtim me këtë Rregullore.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

4. Në rast të mungesës të kryetarit, mbledhjen e kryeson nënkryetari i parë.
5. Nënkryetari mund të shkarkohet nga funksioni me shumicën absolute të votave përmes një votimi duke llogaritur numrin e plotë të anëtarëve të PS apo KS.
6. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të nënkryetarit, kryetari thërret mbledhjen për rizgjedhje të nënkryetarit brenda shtatë ditësh.

Neni 59

Mbledhjet e PS dhe KS

1. Kryetari i thërret dhe i kryeson mbledhjet.
2. Nëse kryetari nuk ka mundësi të kryesojë mbledhjen, atëherë mbledhjen e kryeson nënkryetari i parë. Në rast se në mbledhje nuk mund të marrin pjesë kryetari dhe asnjë nga nënkryetarët, atëherë mbledhjen e kryeson sekretari i PS/KS.
3. Kryesuesi thërret takimet e PS/KS sipas nevojës. Gjatë periudhës së studimeve, mbledhjet e rregullta të PS duhet të mbahen së paku njëherë në muaj ndërsa mbledhjet e rregullta të KS duhet të mbahen së paku një herë në dy muaj.
4. Takimet e jashtëzakonshme të PS/KS mund të mbahen në çdo kohë sipas procedurave të parapara, mirëpo rendi i ditës duhet të kufizohet në një pikë. Gjatë mbledhjes së PS/KS mund të përcaktohet edhe takimi pasues. Në këtë rast anëtarët që mungojnë në mbledhje të PS/KS duhet të ftohën veçmas.
5. Në rast të shkarkimit apo dorëheqjes së kryetarit dhe të gjithë nënkryetarëve, atëherë Këshilli Drejtues autorizon sekretarin e përgjithshëm të inicioj dhe zhvilloj procedurat zgjedhore për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve, në pajtim me rregulloren dhe pa ndonjë vonesë.
6. Mbledhjet e PS/KS duhet të jenë të hapura për publik, përveç në ato raste kur PS/KS vendos ndryshe.
7. Anëtarët e PS/KS duhet të ftohën nga sekretari së paku 3 ditë para mbajtjes së mbledhjes, ftesa mund të behet me shkrim ose përmes e maillit.
8. Kryesuesi ka të drejtë që në mbledhje, në çdo kohë të ftojë ekspertë për mbështetje profesionale.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

9. Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen pa vonesë nëse një gjë e tillë kërkohet nga një e treta e anëtarëve të PS/KS dhe nëse propozimi me shkrim ka arsye të fortë. Paraqitësit e kërkesës kanë të drejt të kërkojnë nga nënkryetari i parë të thërrasë mbledhjen e PS/KS duke lënë jashtë kryesuesin.

Neni 60

Pjesëmarrja në mbledhje dhe zëvendësimi

1. Të gjithë anëtarët e PS/KS kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje të organit përkatës.
2. Gjatë takimeve të PS/KS, anëtarët votojnë vetëm personalisht. Delegimi i votës nuk është i lejueshëm.
3. Anëtarët duhet të nënshkruajnë listën e pjesëmarrjes në secilin takim të PS/KS, lista e pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e procesverbalit të mbledhjes e cila përgatitet dhe distribuohet nga sekretari. Anëtari mund të mungojë për shkaqe të arsyeshme dhe për këtë duhet të njoftohet me kohë kryesuesi.
4. Anëtari i PS/KS, mund të mungoj në mbledhje vetëm me një arsyetim dhe mungesa duhet të lajmërohet tek kryetari.
5. Nëse anëtari i PS/KS, nuk ka marr pjesë në takime për 6 muaj me radhë, të njëjtit i pushon mandati.

Neni 61

Konflikti i interesit

6. Anëtari konsiderohet se është në konflikt interesi nëse mandati i tij është në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore.
7. Nëse PS/KS nuk vendos ndryshe, anëtari në konflikt të interesit duhet ta lëshoj mbledhjen gjatë kohës kur diskutohet dhe votohet për çështjet për të cilat konsiderohet se ka konflikt të interesit.
8. Vendimet për përjashtimin e një anëtari nga tema apo takimi për arsye të konfliktit të interesit, mund të kontestohet brenda dy ditëve përmes një deklarate me shkrim e cila i adresohet Këshillit Drejtues dhe vendoset në një afat të arsyeshëm. Në rast të pranimit të kërkesës, çështja



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

duhet të rivendosët në rend të ditës për mbledhjen vijuese të organit përkatës dhe të gjitha vendimet paraprake konsiderohen si të pavlefshme.

Neni 62

Fillimi i mbledhjes dhe aprovimi i rendit të ditës

1. Kryesuesi e hapë, e kryeson, e ndërprejë dhe mbyllë mbledhjen.
2. Rendi i ditës duhet të përgatitet nga kryesuesi në bashkëpunim me nënkryetarët dhe sekretarin.
3. Kryesuesi është i obliguar të përfshijë kërkesat me shkrim në rend të ditës, të cilat kanë qenë të dorëzuara me kohë, më së voni 48 orë para mbledhjes dhe të cilat kanë bazë. Në kërkesat me shkrim duhet të vendosët nënshkrimi origjinal i paraqitësit dhe ajo mund të dorëzohet me shkrim ose me e-mail.
4. Mbledhjet e PS/KS duhet të kenë kuorumin prej 50+1 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
5. Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konfirmon anëtarët pjesëmarrës dhe ata në mungesë dhe pasi siguron kuorumin, propozon rendin e ditës, hap diskutimin për rendin e ditës, konfirmon aprovimin e rendit të ditës dhe e vazhdon takimin sipas pikave të rendit të ditës.
6. Kryesuesi ua jep fjalën anëtarëve për diskutim, siguron përfundimin e diskutimit për një mori temash, vendos çështjet në votim, konfirmon aprovimin apo refuzimin e propozimeve, ndërmer masa të duhura për tu siguruar që takimi ka progres, deklaron mbylljen e takimit dhe ndërmer aktivitete tjera të nevojshme për të kryesuar mbledhjen në pajtim me rregulloren.
7. Anëtarët e PS/KS kanë të drejtë të propozojnë ndryshime apo përfshijnë pika në rendin e ditës dhe duhet ti justifikojnë propozimet.
8. Materialet apo kërkesat e dorëzuara gjatë takimit mund të aprovohen me shumicën absolute të votave.

Neni 63

Rrjedha e mbledhjes

1. Pas aprovimit të rendit të ditës, vazhdohet me diskutime për çështje brenda kornizave të rendit të ditës.
2. Raporti dhe justifikimi për secilën pikë të rendit të ditës prezantohet nga kryesuesi apo personi i caktuar nga kryesuesi, pastaj kryesuesi hap diskutimin.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

3. Të gjithë anëtarët e pranishëm të PS/KS mund të marrin pjesë në diskutim dhe të paraqesin pikëpamjet dhe propozimet për çështjet për të cilat do të vendosët në mbledhje.
4. Kryesuesi i jep fjalën secilit anëtar që kërkon fjalën sipas radhës. Në mbledhje askush nuk mund të diskutojë pa iu dhënë fjala nga kryesuesi.
5. Kryesuesi është përgjegjës që rregullorja e punës të respektohet dhe që anëtarët të sillen sipas rregullit.
6. Për secilën pikë të rendit të ditës një anëtarë mund të diskutojë deri dy herë, herën e parë deri në 5 minuta dhe herën e dytë deri në 2 minuta.
7. Kryesuesi ka të drejtë të iu përkujtojë anëtarëve që t'i kthehen pikës së rendit të ditës.
8. Anëtari i cili e merr fjalën është i obliguar të i përmbahet temës për të cilën diskutohet. Secili anëtarë i cili konsideron se është penguar gjatë diskutimit, me aprovim të kryesuesit ka te drejtë të marrë fjalën përsëri dhe të i përgjigjë folësit paraprak i cili e ka apostrofuar. Replika për çështjet e njëjta është e lejueshme vetëm dy herë dhe ajo mund të zgjasë deri në dy minuta.
9. Kryesuesi ka të drejtë të ndërpres mbledhjen për më së shumti 30 minuta. Me pëlqim të anëtarëve të PS/KS, kjo periudhë kohore mund të zgjatet.
10. Kryesuesi është i obliguar të ndërpres punimet e mbledhjes nëse ai/ajo e konsideron veten jo të aftë të vazhdojë takimin në mënyrë të rregullt.
11. PS/KS me propozim të kryetarit apo ndonjë anëtari tjetër të organit përkatës, mund të vendosë që për vendimet e çështjeve specifike të përgatitën detaje dhe të përcillen në takimin vijues.

Neni 64

Vendimmarrja

1. Vendimet e PS/KS duhet të kenë kuorumin prej 50+1 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të organit përkatës në mënyrë që të jetë i vlefshëm.
2. Para votimit, kryesuesi formulon propozim vendimin apo kërkesën duke u bazuar në temën e rendit të ditës.
3. Pas formulimit të vendimit dhe rishikimit, sipas kërkesës dhe pikave në rend të ditës PS/KS miratohet vendimi dhe nxirren konkluzione.
4. PS/KS merr vendim me shumicën absolute të votave të gjithë anëtarëve të pranishëm.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

5. Nëse ka më shumë kërkesa, së pari votohet për ato që janë në materialet e propozuara dhe pastaj votohet për propozime tjera.
6. Votimi bëhet përmes aklamacionit, me ngritje dore apo përmes votës së fshehtë. Kjo vendosët në mënyrë individuale gjatë takimit PS/KS me shumicë të thjesht votash.
7. Votimi bëhet:
 - “për:
 - “kundër”
 - “abstenim”
8. Në rast të votave të barabarta, kërkesa konsiderohet si e refuzuar.

Neni 65

Votimi i fshehtë

1. Procedura e votimit të fshehtë zbatohet nga komisioni i përbërë prej tre anëtarëve të caktuar nga PS/KS. Këta anëtarë zgjedhën me shumicën e thjesht të votave.
2. Pas votimit të të gjithëve, kryesuesi konfirmon aprovimin apo refuzimin në bazë të rezultatit të votimit.

Neni 66

Votimi i fshehtë në PS

1. Votimi përmes votës së fshehtë në parlamentin studentorë kërkohet për:
 - 1.1.Zgjedhjen e studentëve senatorë në Senat
 - 1.2.Zgjedhjen e kryetarit
 - 1.3.Zgjedhjen e nënkryetarit
 - 1.4.Shkarkimin e kryetarit
 - 1.5.Shkarkimin e nënkryetarit
 - 1.6.Shkarkimin e sekretarit
 - 1.7.Çështjet që kanë ndikim në jetën private të një anëtari të parlamentit studentor
 - 1.8.Çështjet për të cilat kryesuesi kërkon të bëhen me votë të fshehtë
 - 1.9.Çështjet për të cilat shumica absolute e anëtarëve kërkon votim të fshehur
2. Numërimi i votave për këto çështje do të bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Neni 67

Votimi i fshehtë në KS

1. Votimi përmes votës së fshehur në këshillin e studentëve të fakultetit bëhet për:
 - nominimin e listës deri në tre kandidatë për anëtarë në Senat dhe për zgjedhje në parlamentin studentor;
 - Zgjedhjen e kryetarit;
 - Zgjedhjen e nënkryetarit;
 - Shkarkimin i kryetarit;
 - Shkarkimin e nënkryetarit;
 - Shkarkimin e sekretarit;
 - Çështjet që kanë ndikim në jetën privatë të një anëtari të këshillit studentor;
 - Çështjet për të cilat kryesuesi kërkon të bëhen me votë të fshehtë;
 - Çështjet për të cilat shumica absolute e anëtarëve kërkon votim të fshehur;
2. Numërimi i votave për këto çështje do të bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit.

Neni 68

Nominimet e listës së kandidatëve për anëtar të Senatit nga KS

1. Nominimi i listës së kandidatëve, për anëtar të PS, bëhet në nga KS në një mbledhje të veçantë. Kandidatin e zgjedhur nga lista e të nominuarve KS e propozon për anëtarin student të Senatit për t'u zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.
2. Për secilin kandidatë të propozuar duhet të paraqitën një biografi e shkurtë.
3. Votimi për anëtarin e studentëve në Senat, për tu zgjedhur nga PS, bëhet përmes votës së fshehtë me fletëvotim.
4. Kandidati me më së shumti vota të fituara, konsiderohet i nominuar dhe i përcillet PS për votim. Në rastin e votave të barabarta, përsëritet votimi. Nëse votat mbeten të barabarta pas tri votimeve të njëpasnjëshme, vendimi për kandidatët duhet të merret përmes shortit.
5. E tërë procedura e votimit duhet të zhvillohet përmes komisionit zgjedhor i përbërë prej tre anëtarëve, në përbërje të sekretarit dhe dy anëtarëve tjerë (duke përjashtuar kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin), të cilët zgjidhen nga KS me shumice të thjesht votash.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

6. Kandidati i zgjedhur, i nominuar për anëtarin e studentëve në Senat, i përcjellët PS për procedurë të mëtejme, me shkresë të veçantë dhe bashkëngjitur edhe procesverbali mbi votimin e fshehtë nga KS.

Neni 69

Zgjedhja e anëtarëve të Senatit nga Parlamenti studentor

1. Parlamenti studentor e zgjedhë anëtarin e Senatit, nga listat e të propozuarve nga këshillat e studentëve, nëpërmes votimit të fshehtë. Kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar ex officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Senatit.
2. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Senatit nga radhët e studentëve dëshmohet përmes procesverbalit dhe fletëvotimeve, të cilat i dorëzohen sekretarit të përgjithshëm të universitetit dhe ruhen në arkivin e Universitetit.
3. Anëtarët e senatit duhet të zgjedhën me votë të fshehtë përmes fletëvotimit.
4. Në fletëvotimet, të cilat duhet të përgatitën paraprakisht nga sekretari, mund të rumbullakohen më së shumti dy kandidatë.
5. Fletëvotimet të cilat përmbajnë më shumë se dy numra të rumbullakuar të kandidatëve konsiderohen si të pavlefshme.
6. Dy kandidatët me më së shumti vota të konsiderohen si janë të zgjedhur për anëtarë në Senat.
7. Për kandidatët të cilët kanë fituar vota të barabarta votohet për të dytën herë sipas rregullave të përshkuara më lartë.
8. Nëse kandidatët edhe pas tri radhëve të votimit kanë vota të barabarta, vendimi për kandidatët e mbetur bëhet përmes shortit.
9. E tërë procedura e votimit duhet të zhvillohet përmes komisionit zgjedhor i përbërë prej tre anëtarëve, në përbërje të sekretarit dhe dy anëtarëve tjerë (duke përjashtuar kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin), të cilët zgjidhen nga KS me shumicë të thjesht votash.
10. Në rast të dorëheqjes së hershme të njërit nga anëtarët student të Senatit, kandidati pasues me më së shumti vota nga regjistri burimor (fillestar) automatikisht është anëtarë i Senatit.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Neni 70

Mbajtja e rendit në mbledhjet e PS/KS dhe shqiptimi i masave

1. Kryesuesi është përgjegjës që të mbajë rendin në mbledhje.
2. Kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje të PS/KS janë të obliguar të respektojnë këtë rregullore.
3. Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
 - – Vërejtje me gojë;
 - Marrja e fjalës;
 - Përrjashtim nga mbledhja.

Neni 71

1. Vërejtja me gojë mund t'i shqiptohet anëtarit të pranishëm nëse ai/ajo me sjelljen e tij/saj dhe me mënyrën e diskutimit vështirëson ose krijon obstrukcione në procedim normal të mbledhjes.
2. Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit i cili përmes sjelljes dhe fjalimit pengon procedimin normal të mbledhjes vetëm pasi që i është dhënë paralajmërimi.
3. Vërejtja me gojë dhe marrja e fjalës shqiptohet nga kryetari i PS/KS.
4. Anëtari përjashtohet nga takimi nëse atij edhe pas i është marrë fjala ai/ajo ka vazhduar të pengojë mbledhjen.
5. Largimin nga mbledhja e shqipton PS/KS me shumicë votash. Pjesëmarrësit të cilit i VshtV shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

Neni 72

Procesverbali i mbledhjeve të PS/KS

1. Proces verbali duhet të mbahet për secilin takim të PS/KS. Procesverbalin e nënshkruajë kryesuesi dhe sekretari pas takimit në mënyre të rregullt. Në rast të mungesës së sekretarit, kryesuesi cakton përkohësisht një person për mbajtjen e procesverbalit.
2. Procesverbali duhet të përmbajë elementet si në vijim:



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

- Vendin, datën, kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes;
 - Rendin e ditës;
 - Listën e pjesëmarrësve;
 - Të gjitha kërkesat dhe vendimet përkatëse;
 - Përshkrimin e përgjithshëm dhe shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.
 - Dokumentet tjera shtesë duhet të bashkëngjiten si aneks në procesverbal.
3. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes të PS/KS dhe si ekstrakt duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarët e PS/KS, kur shpërndahen edhe materialet për mbledhjen e radhës të PS/KS.
4. Procesverbali aprovohet në mbledhjen vijuese të PS/KS;
5. Procesverbali duhet të arkivohet bashkë me të gjitha materialet sipas radhës dhe rendit të ditës si dokumentacion afatgjatë. Sekretarit të Përgjithshëm i dorëzohet nga një kopje relevante e materialeve nga sekretari përkatës një herë në semestër.
-

Neni 73

Puna e komisioneve të PS/KS

1. Parlamenti i studentëve dhe Këshillat studentore, me kërkesë të organeve të Universitetit, përkatësisht të fakultetit, propozojnë studentë për të marr pjesë në komisionet ndihmëse të këtyre organeve.
2. Anëtarët e komisioneve duhet të jenë studentë të dalluar me notë mesatare së paku tetë (8), dhe nuk duhet të jenë përsëritës të vitit akademik.
3. Komisionet e formuara nga PS/KS, në pajtim me Statutin e UIBM i ndihmojnë organet përkatëse të UIBM dhe fakultetit për çështje të caktuara të punës së tyre.
4. PS/KS formojnë edhe komisione tjera ndihmëse për punën e PS/KS.

Neni 74

Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat e kësaj rregullore vlejnë për anëtarët e parlamentit studentor dhe anëtarët e këshillit studentor dhe për të gjithë personat e tretë të ftuar apo të kyçur në procedurat e PS/KS.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË**

2. KQZ/KZF, kryetari i PS/KS janë përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore.
3. Për çështjet të cilat nuk janë paraparë në këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe Statutit të UIBM. Në rast të konfliktit të ndonjë dispozite të kësaj rregullore, vlejnjë dispozitat e legjislacioni në fuqi dhe të Statutit të UIBM.
4. Për të gjitha çështjet lidhur me vendimet apo procedurat e kontestuara lidhur me këtë rregullore, Këshilli Drejtues i UIBM do të marr vendim përfundimtar.
5. Interpretimin autentik të kësaj rregullore e bënë Këshilli Drejtues.

Neni 74

Zgjedhjet studentore si dhe fushata zgjedhore e organizatave studentore, sikurse është paraparë në nenin 11, paragrafi 3 dhe 4, do të zhvillohen në harmoni me MANUALIN PËR MBROJTJE NGA PËRHAPJA E VIRUSIT COVID-19.

Neni 75

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja për zgjedhjet studentore Nr. 438/005 Dt. 31.03.2017 dhe Rregullorja mbi punën e Parlamentit studentor dhe këshillave të studentëve Nr. 457 Dt. 30.04.2015;

Neni 75

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.



Prof. dr. Ali Topalli

Kryesues i KD